



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 96-të të mbajtur më 27.11.2023, ka miratuar sa vijon,

VENDIM

Denoncimi I regjistruar me numër 12-546/1 nga 30.01.2023, me akuzat për mosmarrje të masave ndaj shitësve të paligjshëm të valutës së huaj në -----, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se, sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-546/1 nga 30.01.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Më datë 30.01.2023, një parashtrues i njohur ka bërë denoncim me pretendimin për mosmarrje të masave ndaj shitësve të paligjshëm të valutës së huaj në ----- dhe është konstatuar rasti numër 12-546./1 nga 30.01.2023.

Në denoncim thuhet se është bërë kallëzim penal në Prokurorinë Publike ----- kundër shitësve të valutës së huaj nga këmbimoret e autorizuara në -----, -- disa vite më parë dhe për të njëjtin problem, u kërkua ndihmë nga ----- . Gjithashtu, thuhet se vitin e kaluar në kallëzim penal është dorëzuar një shtesë me emrat dhe mbiemrat e shitësve dhe mënyrën e punës së tyre, si dhe është futur një inspektor shtetëror i këmbimit valutor, i cili u zotua për zgjidhjen e problemit, por sipas kërkuesi, pa sukses, duke pasur parasysh se e tillë sipas tij, mënyra e punës mbështetet nga institucionet kompetente. Në denoncim shprehen pritshmëritë se do të ndërmerren masa nga KSHPK-ja për largimin e shitësve të paligjshëm të valutës së huaj.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se kërkohet veprim që është jashtë kompetencave të KSHPK-së në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, pas së cilës vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent në çështjen në fjalë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dërguar:

- parashtruesi i denoncimit

përgatiti: B.K.SH .
miratoi: G.T anëtar i KSHPK-së.

**KOMISIONI SHETËTOR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska